

VENDIM
Nr. 572, datë 3.8.2016

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TE MINISTRIA E DREJTËSISË,
PËR AGJENCINË E TRAJTIMIT TË PRONAVE, DHE MINISTRIA E PUNËVE TË
BRENDSHME, PËR INSPEKTORATIN KOMBËTAR TË MBROJTJES SË TERRITORIT,
TË KATIT PËRDHES DHE TË KATIT TË TRETË E TË KATËRT TË GODINËS SË
INSTITUTIT TË NDËRTIMIT, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të disa mjediseve të godinës së Institutit të Ndërtimit, Tiranë, për t’u përdorur për mjedise pune, institucioneve, sipas ndarjes së mëposhtme:

a) Ministrisë së Drejtësisë, për Agjencinë e Trajtimit të Pronave, kati përdhes i godinës, sipas planimetrisë që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

b) Ministrisë së Punëve të Brendshme, për Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, kati i tretë dhe i katërt i godinës, sipas planimetrive që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.


2. Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme u ndalohet të ndryshojnë destinacionin e pronës, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojnë ose t’ua japin në përdorim të tretëve.

3. Ngarkohen ministri i Zhvillimit Urban, ministri i Drejtësisë, ministri i Punëve të Brendshme, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë, Agjencia e Trajtimit të Pronave dhe Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

PLANIMETRIA E KATIT PERDHES



PLANIMETRIA E KATIT TE TRETE



PLANIMETRIA E KATIT TE KATERT

